

VENDIM
Nr. 346, datë 5.6.2024

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 145, DATË 11.3.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË
SHIJAK, KAMZË, KAVAJË DHE KRUIJË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 145, datë 11.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

"2/2 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 612 391 723 (gjashtëqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Kavajë dhe Krujë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi, në masën 21 183 261 (njëzet e një milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 591 208 462 (pesëqind e nëntëdhjetë e një milionë e dyqind e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.";

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1 Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe u transferohet bashkive Kavajë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Kavajë e Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku